

Shkrimi është derguar në 15 redaksi, por u botua I plote ne Zeri Popullit dt 17 dhjetor 2010 dhe gazeta Shqip botoi vetem pikat

PYETJE PUBLIKE PËR Z. ELVIS CEFA, DREJTOR I AGJENSISË PRONAVE

Nga kryesia e Shoqatës “Bregdeti”

Prona tek i zoti përbën themelin e të drejtave të njeriut dhe demokracisë, zbatimin e nenit 181 dhe 41 të Kushtetutës, që vazhdon të shkelet. Këtë fakt që e ka deklaruar në shtator 2010 në Kuvendin e Shqipërisë edhe vetë Kryeministri Sali Berisha duke thënë se: beteja për pronën përcakton sistemin dhe lidhet me fatet e demokracisë dhe zbatimin e kushteve që BE kërkon të zbatohen prej Qeverisë Shqiptare. Edhe deputeti Fatmir Mediu, deklaroi në Parlament se prona është grabitur me ligj, por në këto 20 vjet kush i ka votuar këto ligje ? Nga askush nuk mund të kundërshtohet deklarimi i zotit Rrapo Hajredin Danushi se nuk ka demokraci pa pronën tek i zoti se pas vitit 1991 kemi pluripartitizëm dhe sistem kleptokracie, se nuk mund të jemi pjesë e NATOs, e BE dhe demokracisë pa kthyer fizikisht pronën tek i zoti.

Në kompleksin e tyre Kuvendi ka miratuar ligje antipronar, duke filluar nga Neni 8 i ligjit 7501, por edhe nene në ligje të tjera që bien ndesh me të drejtën tonë për pronën e trashëguar. Faji bije mbi politikanët tanë por edhe mbi përfaqësitë e institucioneve ndërkombëtare që megjithse prej shumë vjetësh kanë monitoruar problemin e denacionalizimit të pronave duke shpenzuar fondet të mëdha praktikisht e konstatojnë shkeljen e të drejtës së pronës por heshtin duke u bërë këshut mbështetës të korrupsionit. Po ashtu nenet antipronar që shkruhen në aneksin e ligjit të pronave nr 9235 të vitit 2004, u miratua nën kujdesin e OSBE. Ligjet e këqia të miratuara në Parlament dhe zbatimi i keq i tyre ka bërë të mundur banditizmin me pronat në zonat turistike dhe po imponon zgjidhjen e të drejtës së pronës nëpërmjet korrupsionit ose nëpërmjet vetgjyqësisë që nënkupton dhe gjakderdhjen. Veprimtaria e Agjensisë dhe e institucioneve të tjera përfshi Prokurorinë, Prefektin, Inspektoriatin ose Policinë Ndërtimore konstatojnë shkelen flagrante të ligjit me qëllim vjedhjen e pronës por kryejnë veprime shumë të ngadalshme.

Duke u bazuar në emisionin e ditës së Dielë, të transmetuar dt 12 Dhjetor 2010 në TV Skan për debatin për pronat, ku ju z. Cefa përfaqësonit Agjensinë (d.m.th. shtetin që duhet të zbatojë ligjet e miratuara , nenin 181 dhe 41 të Kushtetutës), përsërisim për të shumtën herë shqetësimin në emër të pronarëve të vërtetë. Problemi i pronës praktikisht i intereson të gjithë shqiptarëve por veçanërisht pronarëve të zonës turistike Vlorë - Sarandë ku tentakulat e grabitësve janë shumë të dukshme.

Jo vetëm në Dukat por në të gjithë zonën e mbrojtur turistike situata është tensionuar nga veprimtaria antipronar e Agjensisë së Kthimit të Pronave që në fakt vepron për të bllokuar pronarët dhe favorizon shkelësit e ligjeve. Drejtori i AKKP, që është një prej institucioneve që ta kthen pronën tënde ose të mban peng shumë vjet pa ta kthyer pronën tënde dhe krijon hapësirë kohe që pronën tënde ta legalizojnë ose ta pushtojnë persona të tjerë, del shpesh në TV dhe gjithmonë përdor termin ish pronar për ne që jemi pronarët, flet për kompensimin duke anashkaluar faktin se nuk ka përfunduar kthimin fizik. Gazetat pasqyrojnë rregullisht veprimtarinë e Agjensisë dhe të ALUIZNI-t dhe çdo ditë njoftojnë për legalizimet dhe kompensime.

Për rëndësinë e problemit që u diskutua në emisionin e TV Skan i drejtojmë publikisht z. Elvis Cefa, Drejtor i AKKKP këtë letër publike: Në interpretimin tuaj juridik të nenit 181 dhe 41 të Kushtetutës, zbatimi i të cilës është i detyrueshëm për cdo institucion shtetëror, pyetjet tona janë:

1. Ju zoti Cefa gjatë gjithë emisionit por dhe në emisione të mëparshme na quani ish pronarët dhe shmangni për ne termin pronarët . Sipas pikpamjes tuaj kthimi i pronës nga Agjensia është detyrim i shtetit që të kthejë pronën e grabitur tek i zoti apo lëmoshë dhe zemërmirësi e shtetit ?

2. A ka Agjensia të dhënat se cilat janë prona ku pronar është shteti dhe cilat janë prona të shtetëzuara nga diktatura.

3. Pronat e shtetëzuar nga diktatura pas vitit 1945, ju z. Cefa i konsideroni prona shtërore me të cilat mund të jepni vendime legalizimi apo kompensimi, apo i konsideroni prona që duhet ti kthehen fizikisht të shpronësuarit padrejtësisht nga diktatura.

4. Nëse ju mund të dispononi me kompensime dhe legalizime në pronat e shtetëzuara, që prej vitit 1993 janë shpallur zona me përparësi zhvillimin e turizmit a mund të na thoni cilët ligje zbatoni konkretisht

5. A jeni dakort me mendimin tonë se Dukati është reagim mbrojtës i popullit ndaj strategjisë së pushtetarëve për të vjedhur pronat tona të trashëguara dhe se Dukati nuk është rast i shkëputur por do jetë reaksion zinxhir nëse nuk kthehet me ligj prona tek i zoti.

6. Ju z. Cefa deklaruat në emision për zbatimin skandaloz të ligjit 7501 dhe deklaruat të vërtetën kur thatë se Ligji 7501 nuk lejonte shpërndarje toke në zonat turistike por në fakt ky fenomen haset kudo nga uji i Ftohtë Vlorë deri në Sarandë. Në zonën e mbrojtur edhe ndërtimet pa leje nuk mund të legalizohen, por përse ju si drejtor i AKKP përse nuk zbatoni ligjin por mbani peng pronarët. Përse nuk vini para përgjigjjes së ZRPP Qarkut Vlorë pasi është skandaloze dhe kriminale që në zonat turistike të bëhet legalizimi dhe kompensimi pa përfunduar më parë kthimi fizik Skandaloze është mos bashkërendimi i punës së organeve shtetërore p.sh. Agjensisë me hallkat e tjera të shtetit, Polici Ndërtimore, Prokurori, Kontrollin e Shtetit, Antikorupsionin etj. Shembull i pa kundërshtueshmë është Jala, ku për të plotësuar interesat e klaneve Policia Ndërtimore shëmbi ndërtimet që kishin bërë pronarët në tokat e tyre dhe shumë prej tyre me leje, por nuk preku ndërtimet e personave të tretë që kishin pushtuar tokat e pronarëve. Për këto shembje Shteti duhet të paguaj, për gjyqet e pronave në Strasburg, përsëri buxheti i Shtetit pa një e pa dy do të paguaj, por a nuk është kjo një dëm ekonomik që bie mbi popullin. Agjensia dhe institucionet e tjera, duke favorizuar grabitjen e pronave turistike në zonat e mbrojtura, a nuk dalim të gjitha palët të humbur me përjashtim të disa pushtetarëve.

7. Ju z. Cefa thatë në emision se ka shtetas që kanë marrë “kismetin”(pronën) e pronarit dhe këtë e tha në Parlament dhe Kryeministri Sali Berisha. Ju pyesim po ju që përfaqësoni Shtetin pse e shkëlqen të drejtën e pronës dhe nenin 181 dhe 41 të Kushtetutës, kur pa përfunduar kthimin fizik, jepni vendime për legalizime dhe kompensime, kur në zonën e mbrojtur nuk vepron ligji 7501 dhe po ashtu ligji nuk lejon legalizimet.

8. Ju z. Cefa, pohuat se jemi dëshmitarë se çfarë ka ndodhur në këto 20 vjet... dhe pohuat se në zonat e mbrojtura ligji ja kthen pronën pronarit, por Agjensia e ka bërë këtë kthim me pikatore. Ju pyesim: A mendoni se është më mirë që të bëhet një ligj i ri për një zgjidhje të përgjithshme të problemit që të respektojë të drejtën e pronës që edhe në zonat turistike prona të kthehet tek i zoti ashtu siç është bërë në gjithë veriun e vendit dhe në zonat e turizmit malor si në Vlbonë, në Lurë, në Dibër, etj. A ju intereson ku standard i dyfishtë për bregdetin Vlorë - Sarandë dhe të gjithë të kalojë një nga një si trespie në tavolinën tuaj.

9. Ju deklaruat se Agjensia është një dhe pronarët janë shumë. Keni të drejtë. Në dijeninë tonë ligji 9235 e ndalon pronarin që ti drejtohet gjykatës pa marrë një përgjigje negative nga Agjensia. Fakti që sipas ligjit çdo vendim duhet të shqyrtohet nga ana juaj, dhe nr total i dosjeve që presin në Agjensia është 7000, ju pyesim sa dosje në javë mund të shqyrtojë një jurist aq më tepër kur ai është edhe Drejtori i institucionit që është i detyruar të zhvillojë disa takime dhe të bëjë rraporte. Ju pyesim zoti Cefa: Cila është data e dosjes më të hershme të plotë me të gjitha kërkesat që pret në Agjensia? Sipas ligjit 9235 në fuqi sa është koha brenda të cilës një dosje duhet të ketë marrë një përgjigje? Kur do ti jepni ju vendimin pronarit të fundit nëse sot keni 7000 dosje dhe gjatë kohës nuk do shtohet asnjë dosje tjetër?

10. Vonesa deri shumë vjet që bën Agjensia për pronarët, a i favorizon shkelësit e ligjit që kanë ndërtuar duke pushtuar tokat në zonat turistike dhe kanë ndërtuar pa leje, kur ligji parashikon se legalizimi duhet të marrë përgjigjen brenda 45 ditëve. A është mekanizëm bllokimi për pronarët, që e ka parashikuar ligji dhe e zbatoni ju nëpërmjet organizimit të punës në Agjensia.

11. Në vlerësimin tuaj pakësohet apo shtohet anarkia e pronës , tensioni social dhe telashet e konfliktet shoqëruese nëse kompensimi dhe legalizimi në zonat turistike që ligji nuk i lejon, nga ana juaj po bëhen me ritme të shpejta dhe para se të ketë përfunduar kthimi dhe shpallja e pavlefshmërisë për aktet e paligjshme.

12. Ju z. Cefa folët me pasion për fondin e kompensimit që në emision sipas argumentimit të zotit Vorbsi shkon miliarda. A keni bërë llogaritë se me ritmet e derisotme kur do të përfundojë plotësisht detyrimi i shtetit për kompensimin.

13. Ne pronarët e zonës turistike nuk pranojmë kompensim dhe pronat tona ti trashëgojnë pushtetarët grabitqarë që i ka konstatuar dhe kryeministri z. Sali Berisha. Ne kemi deklaruar se ky lloj kompensimi është mashtrim ose vjedhje me ligj. A jeni dakort me mendimin se kompensimin dhe nese këtë e justifikon neni 181 dhe 41 etj i Kushtatutës, Agjensia le të ja japi atyre që do tu merret prona jonë që këto 20 vjet ata shtetas e kanë përvetësuar dhe po pasurohen padrejtësisht.

14. A mendoni se shtytja e kohës për kthimin fizik po i imponon popullit vetgjyqësinë dhe ju si drejtor i Agjensisë jeni një nga faktorët e kësaj gjakderdhje të mundëshme që po kërcënon popullin.

15. Ju zoti Cefa deklaruat se Agjensia nuk ka detyrë mbrojtjen e teritorit nga ndërtimet pa leje, por përse për pronat e “zonës së mbrojtur” nuk i drejtoheni zyrtarisht dhe të bashkëveproni me Policinë Ndërtimore, por mbani peng prej disa vjetësh dosjet e pronarëve për ato prona që shteti duhet t’ja kthejë fizikisht të zotit dhe në mos sot sot nesër ky kthim do bëhet.

16. Në rastet kur ALUIZNI jep vendim legalizimi për ndërtimet në zonën e mbrojtur dhe Agjensia pranon kompensimin, a bëheni ju bashkëpunëtor në trafikun e paligjshëm të pronave që pronarit ju shpronësuan në 1945 nga diktatura ?

Shprehim besim se do kemi nga ju një përgjigje në shtyp që tju sqaruar gjithë pronarëve këto pyetje, që ju interesojnë.